

## **Kushtet e udhëtimit**

**Data: 10.02.2012**

Bazuar në Ligjin e Turizmit dhe Shërbimet Turistike nr. 03/L-168 (të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, të Republikës së Kosovës) dhe Udhëzimit administrativ për licencimin e veprimtarive të agjencive turistike, pronari i NTSH VIP TRAVEL me seli ne Prishtine vërteton:

## **Kushtet e përgjithshme ne udhëtim**

Kushtet e përgjithshme ne udhëtim janë pjesë e kontratës në mes të udhëtarit dhe NTSH VIP Travel si organizator, përveç marrëveshjeve të veçantat të definuar me shkrim paraprakisht.

## **Rezervimi**

Secili udhëtar i cili paraqitet ne zyret e NTSH VIP Travel (organizatori) lidhur me rezervimet e pushimeve apo biletave është i obliguar qe të bëjë pagesën në tërësi apo 50% të vlerës totale si dhe pjesën tjetër 10 ditë para nisjes. Nëse udhëtari nuk paraqitet ne kohet e caktura me kontratë, atëherë rezervimi llogaritet si i anuluar ne tersi, kurse pjesa e paguar është e pakthyeshme.

## **Devizat, dogana dhe rregullat shëndetësore**

Ju jeni të obliguar t'i respektoni rregullat doganore të Republikës së Kosovës dhe të shteteve përkatëse qe i vizitoni gjatë udhëtimit. Gjithashtu ju duhet të informoheni paraprakisht në lidhje me rregullat shëndetësore të vendeve ku ju do të udhëtoni dhe nëse është e nevojshme t'i siguronit dokumentet shëndetësore (librezën e vaksinimit, etj). Në rast të shkeljes së rregullave të devizave, doganave dhe rregullave shëndetësore, ju do t'i bartni vetë të gjitha shpenzimet e lindura.

VIP Travel ju rekomandon që të bëni sigurim shëndetësor në çdo udhëtim.

## **Dokumentet e udhëtimit**

Ju si klient jeni të obliguar që gjatë gjithë udhëtimit të posedoni të gjitha dokumentet e nevojshme për udhëtim dhe ato të jenë në rregull dhe valide (pasaportë, vizë, dokumentin shëndetësor, ftesë, kupon hoteli, sigurim shëndetësor, etj). Ju duhet t'i mbuloni të gjitha shpenzimet në rast se udhëtimi juaj ndërpritet apo ndryshohet për shkak të dokumenteve të udhëtimit.

VIP Travel nuk merr përgjegjësi në rast se juve ju ndalohej hyrja në destinacion nga policia, dogana apo nëpunësit e atij shteti, por edhe në rastet ku dokumentet e udhëtimit janë në rregull.

## **Obligimet e organizatorit**

Organizatori është i obliguar që udhëtarit ti shpjegoj të gjitha detajet lidhur me aranzhmanin dhe udhëtimin për të cilin është vendosur paraprakisht,

- a. Kushtet dhe oraret e udhëtimit
- b. Kushtet e transportit
- c. Kushtet e hotelit përkatës dhe se çfarë është e përfshirë ne paket.

NTSH VIP Travel është ndërmjetësues mes udhëtarit dhe hoteleve si dhe ne rast te anulimit apo ndonjë problemi eventual VIP TRAVEL është i obliguar qe te bej zgjedhjen e ndonjë hoteli tjetër qe është kategori e njëjte ose me i mire.

## **Obligimet e udhëtarit**

Udhëtari duhet që në mënyrë profesionale te njoftohet nga organizatori lidhur me kushtet e udhëtimit.

Të bëjë pagesën e çmimit sipas marrëveshjes paraprake si dhe ti respektoj afatet e pagesave, qe organizator të ketë mundësi qe ne afat ti dozojë te gjithë dokumentacion e nevojshëm për organizim.

Udhëtari është i obliguar ti kontrolloj këto te dhënat para se te merr biletën apo aranzhmanin:

- a. Pasaportën dhe vlefshmërinë
- b. Vizën
- c. Emrin dhe mbiemrin
- d. Datën e udhëtimit
- e. Te jete dy ore para orës se nisjes ne aeroport
- f. Si dhe te dhënat tjera

Ne rast se këto te dhen ajane gabim pasi qe te procedohet bileta VIP TRAVEL nuk merr asnjë përgjegjësi përveç rasteve te cilat janë te evidentuara me shkrim.

Udhëtari është obliguar që gjatë gjithë udhëtimit të posedoni të gjitha dokumentet e nevojshme për udhëtim dhe ato të jenë në rregull dhe valid (pasaportë, vizë, dokumentin shëndetësor, sigurim shëndetësor, etj). Ju duhet t'i mbuloni të gjitha shpenzimet në rast se udhëtimi juaj ndërpritet apo ndryshohet për shkak të dokumenteve të udhëtimit.

NTSH VIP TRAVEL nuk merr përgjegjësi në rast se juve ju ndalohet hyrja në destinacion nga policia, dogana apo nëpunësit e atij shteti, por edhe në rastet ku dokumentet e udhëtimit janë në rregull.

## **Akomodimi, transport dhe sigurimi ne udhëtim.**

Nëse udhëtari nuk është marr vesh paraprakisht lidhur me akomodimin te formës se kërkuar, ai do te pranoj çfarëdo lloj akomodimi banda objektit përkatës pa marr parasysh pozitën e objektit, katin apo lartasin. Ndërrimi i objektit te kategorisë me te larte mund te jete i njëanshëm, kurse ndërrimi i objektit ne kategori me te ulte duhet te jete ne pajtim me udhëtarin.

Udhëtari ne rast te nderimit te kushteve apo llojit te akomodimit duhet patjetër te lajmoj organizatorin ne te kundërtën organizatori nuk merr asnjë përgjegjësi pasi te përfundoj pushimi. Udhëtari duhet qe ne kohen e akomodimi ne hotel te njoftohet me rregullat e hotelit si dhe me shërbimet te cilat janë jashtë paketës e qe duhet paguar ekstra te hoteli.

Transporti i udhëtareve behet nga aeroporti ne hotel përmes partnerit te organizatorit, si dhe çdo udhëtar duhet me kohe te lajmohet ne sportelet përkatëse si dhe ti respektoj rregullat dhe oraret me te cilat janë te njoftuar paraprakisht. Nëse udhëtari vonohet ne oraret me te cilat është i informuar atëherë organizatori nuk do te merr asnjë përgjegjësi për shpenzimet tjera te cilat i krijohen. Udhëtari nuk është i obliguar patjetër qe te ketë sigurim ne udhëtim, mirëpo ne rast te ndonjë ndodhje eventuale organizatori nuk është përgjegjës.

## **Ndryshimi i çmimeve dhe programeve.**

Organizatori i cili ne disa raste edhe ndërmjetëson ka te drejt qe te ndryshoj çmimin pas publikimit te ofertave nëse ka pranuar ndonjë informate nga partneri. Si dhe me kohe te informoj udhëtarët ne rast se ka ndonjë rezervim paraprak. Organizatori nuk ka përgjegjësi nëse fluturimet janë anuluar për shkak te kushteve atmosferike ose ndonjë problemi me avio-kompaninë, përveç qe udhëtarin te vendos ne ndonjë date tjetër.

## **Anulimi i udhëtimit**

Udhëtari ka të drejtë të tërhiqet nga udhëtimi, për të cilën është i obliguar që organizatorin ta njoftoj me shkrim. Data e dorëheqjes me shkrim paraqet bazën për llogaritjen e kompensimit e cila i takon organizatorit, e shprehur në përqindje në raport me çmimin e përgjithshëm të udhëtimit, nëse me programin e udhëtimit nuk është ndryshe e specifikuar dhe kjo si vijim:

- 5% nëse udhëtimi është anuluar 45 ditë para fillimit të udhëtimit.
- 10% nëse udhëtimi anulohet prej 44 deri 30 ditë para fillimit të udhëtimit,
- 50% nëse anulohet 14 deri 10 ditë para fillimit të udhëtimit,
- 80% nëse anulohet 9 deri 6 ditë para fillimit të udhëtimit,
- 100% nëse anulohet 5 deri 0 ditë para fillimit të udhëtimit ose gjatë udhëtimit.

## **Bagazhi**

Transportin e bagazhit e bene aviokomania përkatëse, është pa pagese ne disa raste. Për bagazh shtesë udhëtari e paguan çmimi sipas aviokompanis përkatës. Preferohet qe gjerat me vlere te merren me vetin ne bagazhin e dorës. VIP TRAVEL nuk merr përgjegjësi për humbjen e bagazhit përveç asistencës te cilën do t'ja ofroj udhëtarit.

## **Mbrojtja e te dhënave personale**

Te dhënat personale jepen vullnetarisht tek organizator, si dhe përdoren nga organizatori qe te realizoj udhëtimin e tij apo pushimin. Organizatori është i obliguar qe te dhënat ti mbaj për nevoja te udhëtimit dhe nuk ka te drejt te jep detaje lidhur me datën, vendin dhe kohen e udhëtimit vetëm ne raste te veçanta sipas ligjeve ne fuqi.

## **Zbatimi**

Ne rast te kontestit gjyqësor kompetente është Gjykata përkatëse ne Republikën e Kosovës.